



He. prot. 3139/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

27.11.2020

VENDIM

Nr. 42 datë 27/11/2020

**“MBI ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME  
INSTITUCIONALE DHE TË KËSHILLIT TË ETIKËS NË UNIVERSITETIN E  
TIRANËS”**

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, germa “i, neni 44 dhe neni 46; në Statutin e Universitetit të Tiranës, nenet 37, 38, 40, 41, 42 dhe 43, si dhe në propozimin e Kryetarit Prof. Dr. Artan Hoxha, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

**VENDOSI:**

1. Të zhvillojë procesin zgjedhor për anëtarët e komisioneve të përherëshme institucionale dhe të Këshillit të Etikës në Universitetin e Tiranës, në datën 7 dhjetor 2020.
2. Listat e kandidatëve që do të votohen për secilin komision dhe për Këshillin e Etikës, të cilët kanë aplikuar sipas Vendimit Nr. 41, datë 21.10.2020 të Senatit Akademik, i janë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Komisioni i administrimit të votimit miratohet me këtë përbërje:
  - Klodjan Skënderaj
  - Adriatik Kotorri
  - Ederjon Ibro
2. Votimi do të zhvillohet i fshehtë ditën e hënë, datë 7 dhjetor 2020 nga ora 09:00-13:00. Procesi i votimit do të kryhet fizikisht në Sallën e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. ARTAN HOXHA